

KËRKESË
Nr. 11641, datë 14.9.2018
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rishikimi i projektit “Vlora-ACU, rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë shëtitores ‘P4_C2_a, b, c’”.

Subjekti kërkues i shpronësimit është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkohet që të vihen në dijeni personat të cilët preken nga rishikimi i projektit “Vlora-ACU, rikualifikim urban në qytetin e Vlorës, përgjatë shëtitores ‘P4_C2_a, b, c’”, për shpronësimin e pasurive të tyre, si dhe masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 12 891 999 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA RISHIKIMI I PROJEKTTIT “VLORA-ACU, RIKUALIFIKIM URBAN NË QYTETIN E VLORËS, PËRGJATË SHËTITORES, ‘P4, C2, a, b, c’”, VLORË

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Rre-thi	Sipërfaqja e ndërtimit (m²)	Sipërfaqja e truallit (m²)	Çmimi i ndërtimit (l/m²)	Çmi-mi i truallit (l/m²)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera totale (truall + ndërtesë) (lekë)	Konfirmim ZVRPP
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Edlira Tola	ZK 8602	27/89-1	Vlorë	-	240	-	10903	-	2,616,720.00	2,616,720.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, pasuri e llojit truall
2	Bashkëpronarët Xhaferi	ZK 8602	27/364-ND	Vlorë	42	-	51011.54	-	2.142,485.00	-	2.142,485.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, pasuri e llojit ndërtesë (banesë), pasuria 27/364 -ND ngrihet mbi truall 27/356
3	Merita Kapllanaj	ZK 8602	27-580	Vlorë	126.3	126.3	51011.54	10903	6,442,758.00	1,377,048.90	7,819,806.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, pasuri e llojit truall + ndërtesë (banesë)
4	Lindita Lëngu	ZK 8602	27/47-NDI	Vlorë	25	-	12519.52	-	312,988.00	-	312,988.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë, pasuri e llojit ndërtesë. Ndërtesa (barakë metalike) është vlerësuar me situacion punimesh. Ngrihet mbi pasurinë 24/47-T, vol. 14, f. 149 në pronësi të bashkëpunëtorë-ve Muço
										SHUMA	12.891.999	